POP 5 Lajmet më të lexuara të 5 minutave të fundit
1 Doni të dini sa fëmijë do të keni? Mjafton një llogaritje e thjeshtë e ditëlindjes tuaj
2 Alba Malltezi: Ja pse është kaq tragjikisht i vërtetë Gent Pjetri
3 Mik me Cllevion prej 20 vitesh, por nuk e vë para Noizy-t! Stresi: Të ulet me këmbë në tokë! Po vepron gabim, mos të harrojë kush ka qenë
4 Lufta/ Sulme me dronë kamikazë iranianë në Kiev, 8 të vdekur! Shkon në 13 numri i viktimave nga rrëzimi i avionit ushtarak rus në kufi me Ukrainën
5 Londër/ Akuzohet se vrau shoqen dhe i preu kokën, dalin pamjet e autores së dyshuar duke tërhequr valixhen në rrugë

Kronikë

# Trafikonin lëndë narkotike, arrestohen babë e bir në Shkodër! Sekuestrohen 1.5 kg kanabis dhe një armë sportive

*Megaoperacioni antidrogë në Shkodër ka rritur bilancin e arrestimeve për kultivimin e lëndëve narkotike*



*Arma e sekuestruar*

Redaksia
15 Tetor, 14:15 | **Përditesimi: 15 Tetor, 14:35**

**SHKODËR-** Megaoperacioni antidrogë në Shkodër ka rritur bilancin e arrestimeve për kultivimin e lëndëve narkotike.

Në fazën e pestë të operacionit, numri i të arrestuarve ka shkuar në 26 mes tyre edhe Sinato Ndreu, Vitor Ndreu ( babë e bir) ndërsa është shpallur në kërkim bashkëpunëtori i tyre.



LEXO EDHE:
**Shpërndante lëndë narkotike, arrestohet 20-vjeçari shqiptar në Itali**

Nga ky operacion janë sekuestruar 3 pako me lëndë narkotike kanabis, si dhe doza kanabisi, të gatshme për shitje, me peshë totale 1.5 kg. Në banesën e të arrestuarve është sekuestruar edhe 1 armë sportive.

Materialet i kaluan Prokurorisë pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Shkodër, për veprime të mëtejshme, për veprat penale "Prodhimi dhe shitja e narkotikëve", "Mbajtja pa leje dhe prodhimi i armëve, armëve shpërthyese dhe i municionit" dhe "Pastrimi i produkteve të veprës penale ose veprimtarisë kriminale".

**Si u zbulua kultivimi i lëndëve narkotike dhe të arrestuarit:**

Policia e ***Shkodrës*** zbuloi sot detaje të reja të megaoperacioni 'Qarku', që coi në zbulimin e shtëpisë së barit në fshatin Bardhaj.

Në bashkëpunim me njëri-tjetrin, 17 persona kanë kryer veprat penale "Kultivimi i bimëve narkotike" dhe "Prodhimi dhe shitja e narkotikëve" dhe "Pastrimi i produkteve të veprës penale ose veprimtarisë kriminale". Në vijim të kontrollit, shërbimet e Policisë gjetën dhe sekuestruan 86 kilogramë kanabis, dy ventilatorë që shërbenin për tharjen e bimëve narkotike, 3 automjete dhe 15 aparate celulare.

**Anëtarët e një familje në pranga**

Në flagrancë u arrestua dhe çifti i bashkëshortëve, Zef Gjoni, 53 vjeç dhe Antoneta Gjoni 55 vjeçe, së bashku me 3 djemtë e tyre: Elvis Gjoni, 24 vjeç, Roland Gioni, 22 vjeç, Pjeter Gjoni, 31 vjeç, dhe bashkëshortja e këtij të fundit Flora Gjoni 29 vjeçe.

Djali tjetër i çiftit të bashkëshortëve, 31-vjeçari Fabion Gjoni është shpallur në kërkim.

Nga hetimet ka rezultuar se Pjetër Gjoni, grumbullonte bimë narkotike kanabis për përpunimin dhe përgatitjen për shitje. Ata, dyshohet se në bashkëpunim me njëri-tjetrin, kanë kryer veprat penale "Kultivimi i bimëve narkotike" dhe "Prodhimi dhe shitja e narkotikëve" dhe "Pastrimi i produkteve të veprës penale ose veprimtarisë kriminale".

Në vijim të kontrollit, shërbimet e Policisë gjetën dhe sekuestruan 86 kilogramë kanabis, dy ventilatorë që shërbenin për tharjen e bimëve narkoitke, 3 automjete dhe 15 aparate celulare.

G.MO/Shqiptarja.com

TAG: vitor ndreu | sinato ndreu | Shkoder | trafik droge

Komento

© Ndalohet rreptësisht ripublikimi i këtij shkrimi, sipas nenit 80, ligji 35/2016

**Sondazhi i ditës:**
**Rritja e çmimeve, a i keni ulur shpenzimet?**

PO | JO | NUK KAM MENDIM

## Lajme të tjera



Shkodër/ Kultivonin e shisnin kanabis, 7 persona në pranga,5 të tjerë në kërkim! Sekuestrohen 77 kg lëndë narkotike dhe armë! U gjet dhe kokainë
16 Tetor, 16:40



Komandot që u shndërruan në kriminel! SKEDA e plotë e ushtarakëve që konsideroheshin 'elita', por që u bënë vrasës, xhihadistë dhe trafikantë
16 Tetor, 15:50



Përgatiste kanabis për shitje, çfarë dëshmoi pronari që kishte punësuar 10 gra në Shkodër: E bëra nga depresioni, doja të shpëtoja nga borxhet
16 Tetor, 11:42



'Shtëpia e barit' në fshatin Bardhaj të Shkodrës, Gjykata vendos për 16 të ndaluarit: 2 në burg, 2 'arrest shtëpie', punonjëset gra 'detyrim paraqitjeje'
15 Tetor, 17:16



Pedagogët në rrethe nuk i bashkohen protestës, rektorët për Report Tv: S'ka bojkot, të hënën nisim mësimin
14 Tetor, 21:17



Drogë në tualet e para të fshehura nëpër letrat higjienike, arrestohet i riu shqiptar në Itali
14 Tetor, 16:21



I shpallur në kërkim ndërkombëtar nga SHBA për trafik droge, DEA dhe policia vënë në pranga 31-vjeçari indian në Rinas! Pritet ekstradimi i tij drejt Amerikës
14 Tetor, 15:29



Zyrtari i Bashkisë së Vaut të Dejës padi për shefin e komisariatit: Mbushi vendin me kanabis! Reagon Saliu: Gënjeshtër, kontrollet nga Tirana e përgenjështrojnë
14 Tetor, 10:49



Shkatërrohet grupi kriminal në Shkodër, 16 në pranga! 10 gra u arrestuan në flagrancë! Organizatorja gjente punëtore nga Tirana dhe Kruja për përpunim kanabisi
13 Tetor, 09:43



Rritet me 50% çmimi i druve të zjarrit në Shkodër, Bashkia: Kadastra nuk na jep pronësinë e pyjeve
Ergys Kavaja
12 Tetor, 21:23



Gjenden 100 kg kanabis në Shkodër, 'shkatërrohet' grupi me 15 persona, shoqërohen në polici
12 Tetor, 13:16



Zgjedhjet vendore/ Boçi i vë kusht Alibeajt: Tërheqja e ankimimit në Gjykatë pengon bashkimin! Denoncimi për Bashkinë e Vaut të Dejës: Ende s'kam përgjigje nga SPAK
12 Tetor, 12:38








© 2011 - 2022 Shqiptarja.com - Ndalohet riprodhimi i paautorizuar i kesaj faqeje